




2-D/DPKI

01-408/2012

02

31.01.2012



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.01.2012, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I.** Mbyllët rasti më nr.AKK-03-3971/11, për z.Faik Fazliu - Këshilltar Politik në Zyrën e Kryeministrat, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Rasti mund të rihapecit në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

**I.** Në lëndën e trajtuar me nr.AKK-03-3971/11, të dyshuar për konflikt të mundëshëm të interesit janë ndërmarrë veprimet e nevojshme të parapara sipas Ligjit Nr.04/L-051 dhe atyre procedurale sipas nenit 18.1 të po këtij ligji.

Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit të gjendjës është konstatuar se zyrtari i lartë publik, ka qenë pronarë dhe person i autorizuar në një biznesë privatë "FENIKS GROUP" SH.P.K- që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, ka paraqitur konflikt të interesit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit më shkresën njoftuese ka kërkuar nga zyrtari z.Faik Fazliu që ta shmangë konfliktin e mundshëm të interesit.

Në takimin që kanë pasë zyrtarët e Agjencisë me z.Fazliu është deklaruar së nuk ka qenë i informuar së mundë të ketë konflikt të interesit, mirpo është zotuar së brënda afatit ligjorë do ti marrë veprimet e parapara për ta shmangur konfliktin interesit.

Pas këtyre procedurave z.Faik Fazliu me datën 27.01.2012 ka sjellurë dokumentacionin që dëshmon se ka bër ndryshimet në biznesë të këruara nga Agjencia kundër Korrupsionit :

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

